



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/245
Datë: 15.01.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi për Reforma në Ekonomi 2025-2027.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve që dokumentin nga pika 1. të këtij vendimi ta dorëzojë tek zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin për Reforma në Ekonomi nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për informim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/245
Datë: 15.01.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 paragrafit 3. të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr./L-116, Ligjin Nr.04/L-194, Ligjin Nr.05/L-063 dhe me Ligjin Nr.05/L-007, nenit 14, paragrafit 2. të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve që të aprovojë transferet nga nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" në ndonjë nën-program tjetër në tabelën 3.1 dhe 4.1 të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, për shumat individuale të kërkuara deri në vlerën prej dyzet mijë euro (40,000.00 €).
2. Shumat e përgjithshme e autorizimit sipas pikës 1. të këtij vendimi nuk mund të kalojë njëzetë për qind (20%) të shumës së ndarë vjetore të nën-programit "Shpenzimet e Paparashikuara".
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë